

## MENDIM PAKICE

Unë, anëtarja e trupit gjykues Valbona Sanxhaktari, nuk jam dakord me vlerësimin e bërë nga trupi gjykues në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë se subjekti ka treguar një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, për arsytet si më poshtë do të shpjegoj.

Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sip. 104 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, në Korçë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën Vetting si vijon: *“Kam të drejtë përdorimi që e kam marrë nga babai im H. V., i cili disponon Aktmarrëveshje datë 11.1.2012 me shoqërinë e ndërtimit (shitësi) “\*\*\*\*” sh.p.k. Vlera 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, sipas marrëveshjes, nga të cilat të likuiduara 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë. Në vitin 2015 kam filluar bashkëjetesën, për këtë arsye kam filluar të përdor apartamentin e mësipërm. Për arredimin e banesës, gjatë viteve 2015 – 2016 nga kursimet e mia dhe të bashkëjetuesit kam shpenzuar: në vitin 2015, nga kursimet e mia, 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë dhe 700.000 (shtatëqind mijë) lekë nga kursimet e bashkëjetuesit. Për vitin 2016 kam shpenzuar nga kursimet e mia 400.000 (katërqind mijë) lekë dhe nga kursimet e bashkëjetuesit 300.000 (treqind mijë) lekë. Vlera e arredimit gjithsej: 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë”.*

Kjo pasuri është deklaruar në Deklaratën Vetting edhe nga babai i subjektit të rivlerësimit: *“Apartament banimi me sip. 104 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në adresën: Korçë, Lagjia Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, p. nr. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, për të cilin kam nënshkruar Aktmarrëveshjen datë 11.1.2012, me shoqërinë e ndërtimit (shitësi) “\*\*\*\*” sh.p.k. Apartamentin ia kam lënë në përdorim vajzës sime Sonjela Voskopi. Apartamenti nuk është regjistruar në regjistrat publikë në pronësinë time, për shkak të mosshlyerjes së plotë të vlerës së tij. Të ardhurat janë krijuar nga puna ime dhe e bashkëshortes (kursime të depozituara në bankë para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit), si dhe të ardhura të përfituara nga bashkëshortja me dhurim, nga shitja e pronave nga prindërit e saj. Vlera e apartamentit është 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, nga të cilat kam likuiduar 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë”.*

Mbështetur në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit rezulton se pasuria apartament banimi me sip. 104 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, p. nr. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, në Korçë, është porositur nga babai i subjektit të rivlerësimit me një Aktmarrëveshje të datës 11.1.2012, me shoqërinë e ndërtimit (shitësi) “\*\*\*\*” sh.p.k.

Sipas dokumentacionit të ardhur nga shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë dhe FSHU, rezulton se vetë shoqëria e ndërtimit ka vendosur matësit në fund të vitit

2014 e, më pas, ato kanë kaluar duke u regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe/ose bashkëshortit të saj brenda një afati të menjëhershëm apo veprimet për pagesat e faturave mujore janë kryer prej tyre. Më tej, ata kanë deklaruar se në janar të vitit 2015 kanë filluar të jetojnë në këtë apartament pas një sërë investimesh të konsiderueshme të deklaruara prej tyre.

Gjithashtu, vlera e kësaj pasurie rezulton më e ulët se çmimi i referencës dhe vlera e deklaruar e likuiduar sipas akteve në dispozicion është në vlerën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, çka e bën edhe më të ulët koston e kësaj pasurie.

Lidhur me këto konstatime, unë ndaj një qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, pasi vlerësoj se të gjitha rrethanat ngrenë dyshime të arsyeshme se kjo është një pasuri e subjektit të rivlerësimit, të cilën e ka poseduar qysh prej fillimit dhe është sjellë me të si pronare *de facto*, duke e vendosur atë në kushtet e një deklarimi të pasaktë e të pamjaftueshëm.

Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, unë vlerësoj se argumentet e paraqitura prej subjektit se shtëpia ishte e prindërve apo e vëllait të saj, por ata vendosën të jetojnë së bashku në një shtëpi tjetër, atë ekzistuese të blerë në vitin 2003, e cila ishte edhe më e vogël se sipërfaqja e këtij apartamenti, nuk ka një logjikë të pranueshme, duke shtuar mosbesimin lidhur me këtë situatë.

Po ashtu, situata lidhur me pagesat e kryera në vitin 2012 (burimi i të ardhurave dhe mënyra e llogaritjes së tyre) dhe moslikuidimi deri në vitin 2024 i vlerës së mbetur, si dhe gjithë shpjegimi i dhënë prej subjektit lidhur me vlerën e palikuiduar, krijojnë paqartësi, ambiguitet dhe shtojnë dyshimet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë, se nuk ka qenë e sigurtë në deklarimin për këtë pasuri të saj në përdorim dhe se ka dështuar të provojë bindshëm se deklarimi i saj është i plotë e i vërtetë.

Parë në këtë këndvështrim, duket se kjo pasuri ka problematikat e saj sa i përket burimit të krijimit dhe pronësisë apo të drejtave reale lidhur me të, të cilat në vlerësimin tim janë deklaruar në mënyrë të pasaktë nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* dhe se ajo nuk ka mundur të paraqesë argumente bindëse lidhur me faktet e rezultuara gjatë hetimit, të cilat e vendosin atë në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**Valbona SANXHAKTARI**

**Anëtare (Kundër)**